

Numër.....

Podgoricë.....

## **PROCESVERBAL**

nga mbledhja e dytë e rregullt e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve tjerë pakicë dhe bashkësitë tjera të pakicave nacionale

Mbledhja e Komisionit u mbajt më 19.04.2022

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq – kryetar
2. Mirheta Gaçeviq – anëtare
3. Frashër Selimaj – anëtar
4. Ivana Krushçiq – anëtare
5. Tripo Matijeвиq - anëtar

Veron Halili, anëtar nuk mori pjesë në mbledhje për shkak të obligimeve të mëparshme për ç'gjë e njoftoi kryetarin e Komisionit.

Përveç anëtarëve të Komisionit në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Lleković, sekretar i Komisionit.

Me ftesën e anëtarëve të Komisionit lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit e Radios së Malit të Zi, Pjetër Lucaj, redaktor i Programit për pakica, Marash Dedvukaj, redaktor i Redaksisë së programit në gjuhën shqipe dhe Mevludin Begović redaktor i Programit në gjuhët E pjesëtarëve të pakicave tjera.

Në mbledhje u miratua

### **RENDI I DITËS**

1. Diskutim dhe deklarimi lidhur me Procesverbalin nga mbledhja e parë e rregullt e Komisionit
2. Biseda me redaktorët e Programit për pakica, Redaksisë në gjuhën shqipe dhe Programit në gjuhët e pjesëtarëve të pakicave tjera në Radion e Malit të Zi.
3. Diskutim për propozimin e arritjes së kompensimit për anëtarët e Komisionit.
4. Të ndryshme.

### **I**

Procesverbali nga mbledhja konstituive e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm (5 vota për).

### **II**

Frashër Selimaj i pari i drejtua përfaqësuesve të Radios së Malit të Zi me pyetjet lidhur me problemet të cilat po ballafaqohen në punën e vet, si dhe për propozimet eventuale për avancimin e tij. Redaktorët e programeve i informuan anëtarët se nuk ekziston mbulim i mjaftueshëm në territoret e banuar nga popullata shqiptare, si në vend ashtu edhe në rajon.

Është propozuar që të kërkohet më shumë hapësirë për emisionet në gjuhën shqipe. Krahas kësaj u njoftua se Redaksia nuk është e pajisur me kapacitetet teknike në nivel të mjaftueshëm.

Ivana Krushçiq ka pyetur nëse ekziston emisioni i posaçëm i cili merret me kulturën e të gjithë popujve të përfaqësuar në Mal të Zi e që emitohet një herë në javë. Përgjigja e redaktorit ishte se ekziston nga ky vit një emision pilot që emitohet çdo të dytën premtë dhe se planifikohet emisioni që do të emetohet një herë në javë dhe do të merrej me këtë tematik. Për emetim më të shpeshtë ekziston problemi kadrovik. Po ashtu është propozuar nga ana e redaktorëve që anëtarët e Komisionit propozimin t'ia dërgojnë Këshillit e RTMZ me rastin e hartimit të Planit programor dhe të produksionit të Radios së Malit të Zi. Ivana Krushçiq njoftoi se nuk ka emisione autoriale të cilat emetohen çdo ditë dhe kjo paraqet hapësirë për futjen e emisioneve të cilat i ka propozuar, e kanë të bëjnë me kulturën e të gjithë popujve pakicë.

Mirheta Gaçeвиq konstatoi se nuk është aq e thjeshtë që të përgatitet materiali për emision që do të emetohet një herë në javë, para së gjithash për shkaqe financiare dhe mungesës së strukturës kadrovike. Për këtë ajo propozoi që anëtarët e Komisionit të jenë urë lidhëse me Këshillin e RTMZ për projektet që financohen dhe realizohen nga Fondi për pakica dhe Këshillat nacionale, e që paraqesin projekte konkrete për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në kontekstin më të gjerë dhe që do të paraqiste material të gatshëm për emetim në Radion e Malit të Zi.

Admir Adroviq pyeti se sa ka të punësuar në Redaksinë në gjuhët e pjesëtarëve të popujve tjerë pakicë, për ç'gjë e fitoi përgjigjen se z. Begoviq është i vetmi i punësuar dhe se ai i kryen punët edhe në DESK, që ia merr kohën më të madhe dhe se krahas kësaj i kryen edhe punët në Redaksi. Tripo Matijeviq pyeti nëse ende ekziston emisioni, “Valët e përbashkëta” i cili është emetuar në periudhën e kaluar, për ç'gjë iu përgjigjen se emisioni është emetuar çdo të premtë dhe se është tërhequr nga Plani programor dhe i produksionit për vitin rrjedhës. Në këtë rast Tripo Matijeviq konsideron se është dështuese që është ndërprerë emisioni i cekur dhe se do të duhej t'i propozohet Këshillit të RTMZ që ta përfshijë në Planin programor dhe të produksionit. Ai u propozoi anëtarëve të Komisionit që Këshillat Nacional të përfshihen në materialet e përgatitura nga emisionet që emetohen në rajon, të cilat do të riemetoheshin në kuadër të Radios së Malit të Zi së paku një herë ose dy herë në javë. Krahas kësaj konsideron se emisionet për pakica përfshihen 2 deri në 3% të programit që është e papranueshme dhe joproporcionale me numrin e popujve pakicë dhe të bashkësive tjera dhe se kjo përqindje do të duhej të ishte së paku 5%, që do të paraqiste hap përpara. Po ashtu është konstatuar se termini i caktuar i emisionet “Mostovi”, në periudha të mëparshme është tejkaluar për shkak të ngjarjeve sportive dhe se nuk janë emetuar më vonë. Këtë ai e konsideron si lëshim për ç'gjë është përgjegjës menaxhmenti i RTMZ dhe se në të ardhmen duhet penguar situata të tilla dhe se duhet të punohet në avancimin e emisioneve të cekura.

### III

Anëtarët e Komisionit konstatuan se shuma për kompensime që e marrin për punën e vet është joadekuate duke pasur parasysh se nuk ka ndryshuar disa vite, e në ndërkohë ka ardhur deri të rritja e shpenzimeve jetësore si dhe të ardhurave në vend, andaj është konstatuar se lidhur me këtë do t'i drejtohen Këshillit të RTMZ.

### IV

Në kuadër të pikës, “të ndryshme”, nuk ishte tema për diskutim.

PROCESVERBALIN E MBAJTI  
IVAN LEKOVIQ

KRYETARI I KOMISIONIT  
ADMIR ADROVIQ